



**Një vend për t'u rritur:
Komuna kushtuar
fëmijëvet**

Rreth projektit

Projekti “Një vend për t'u rritur: komuna kushtuar fëmijëve” është projekt 30 mujor i zbatuar nga Ambasada e Parë e Fëmijëve në botë Megjashi dhe Qendra për Kujdesin e Familjes dhe Fëmijëve - KMOP Shkup, duke filluar nga shkurti 2023 deri në korrik të 2025. Projekti financohet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në kuadër të skemave lokale për mbështetjen e shoqërisë civile të Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (2021 EIDHR Mbështetja e shoqërisë civile nëpërmjet skemave mbështetëse të bazuara në vend në Maqedoninë e Veriut).

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të forcojë përpjekjet e autoriteteve lokale për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në planifikimin lokal, në pesë komuna në Maqedoni: Vinicë, Dibër, Gostivar, Veles dhe Kisella Vodë.



Sesione informuese të organizuara

Në periudhën prill-maj janë mbajtur sesione informuese në të gjitha komunat pjesëmarrëse në projekt. Këto sesione u organizuan me qëllim të njohjes së përfaqësuesve të komunave, shkollave dhe kopshteve me objektivat e projektit, aktivitetet që do të realizohen, dinamikën e aktiviteteve, rezultatet e pritura dhe rolin e tyre në procesin e realizimit të aktiviteteve.

Në sesionet informuese morën pjesë gjithsej 165 pjesëmarrës nga të gjitha komunat. Sesionet informuese në komunat e Dibrës dhe Kisella Vodës ishin të vizituara edhe kryetarët e komunave të cilët shprehën mbështetjen dhe përkushtimin e tyre për projektin dhe në fjalimet e tyre u referuan edhe nevojave dhe interesave të fëmijëve në komunat e tyre.





Një vend për t'u rritur:
Komuna kushtuar
fëmijëvet



Fokus grupe të organizuara

Paralelisht me mbajtjen e sesioneve informative, janë realizuar edhe fokus grupe me përfaqësues nga komunat, shkollat dhe kopshtet e çdo komune të projektit. Nëpërmjet fokus grupeve, donim të kuptonim më mirë nevojat për edukim shtesë dhe trajnime vijuese në disa fusha që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe planifikimin strategjik lokal për promovimin e të drejtave të fëmijëve në nivel lokal.

Në fokus grupe morën pjesë gjithsej 38 përfaqësues nga komunat dhe të punësuar nga kopshtet, shkollat fillore dhe ato të mesme.



Aktivitetet e radhës

Mendimet, pikëpamjet dhe përvojat që u ndanë nga pjesëmarrësit në fokus grupet do të prezantohen në një raport. Ky raport do të shërbejë për përgatitjen e programit trajnues për ngritjen e kapaciteteve të personelit komunal, si dhe punonjësve në shkolla dhe kopshte në drejtim të promovimit të të drejtave të fëmijëve, që planifikohet të zbatohet në periudhën e ardhshme.

Gjithashtu, raporti do të ndahet me pjesëmarrësit e fokus grupeve, si dhe me publikun e gjerë nëpërmjet kanaleve të komunikimit të projektit.



Projekti financohet nga
Bashkimi Evropian

